



# Biznes si zakonisht – nuk eshte me nje opsion. Parathenie per zhvillimin e qendrueshem permes parimit te kufijve planetare

(Resource ID: 358)

**Jennifer Schnepfer**

jennifer.schnepfer(at)stud.leuphana.de

This teaching resource is allocated to following University:

**LEUPHANA – University of Lüneburg**

<http://www.sustainicum.at/sq/modules/view/358.Biznes-si-zakonisht-nuk-eshte-me-nje-opsion.-Parathenie-per-zhvillimin-e-qendrueshem-permes-parimit-te-kufijve-planetare>



Puna ne□ grupe  
Puna ne□ grup  
Plenium  
(mbledhje)



11 deri ne□ 30  
studente□



4 -7 njesi  
leksionesh



Lidhja me Web  
e nevojshme



Anglisht, Shqip

Burimi i mesimdhenies synon te paraqese idene e zhvillimit te qendrueshem duke perdorur konceptin e "kufijve planetare" me qellim qe te skicoje sisteme planetare te ndrshme dhe limitet e tyre. Ne nje proces nderaktiv, studentet perfitojne njohuri ne fushen e qendrueshmerise dhe zhvillojne te kuptuarin e ndikimit human ne sistemet e Tokes. Gjithashtu, me vone ne fokus vendoset kufiri i ndryshimeve klimatike, te perqendruara ne zonen e Ballkanit me qellim qe te kuptohen rrjedhojat rajonale te ndryshimit klimaterik, duke u perpjekur shume te ofrojne perspektivat lokale dhe ato

globale.

Ky burim mesimdheneije mund te perdoret si nje prezantim per zhvillimin e qendrueshem duke perdorur konceptin e "kufijve planetare" si nje shembull per vizualizimin e nevojës per nje zhvillim me te qendrueshem. Koncepti adreson diskutimin per limitet e sistemeve te Tokës dhe fokuson ne aspektet ekologjike te qendrueshmerise. Ai vizualizon ndikimin e njerezores mbi sisteme te ndryshme te perkufizuara me pare, dhe thekson me tej rendesine e te qenurit ne kufijte e perkufizuar per te mbajtur: nje hapësire operative me te sigurt per njerezimin ( (Rockström et al. 2009). Studentet duhet te fitojne njohuri ne fushen e shkences se qendrueshmerise, te zhvillojne te kuptuarin e presionit njerezor ne sistemet e Tokës, se bashku me te kuptuarin e zgjeruar te te menduarit te sistemeve ne pikepamjen e sistemeve komplekse.

Pas nje prezantimi te shkurter per zhvillimin e qendrueshem dhe te kuptuarin e qendrueshmerise- mbajtur nga lektori- ky burim mesimdheneije fillon duke treguar nje pjese nga TedTalk nga J. Rockstrom. Pjesa e pare pershkruan kater forcat- Rritjen e popullsisë, humbjen e biodiversitetit, ndryshimet klimatike dhe surpriza- e cila ushtroi shume presion tek ekosistemet. Keto presione duhet te vizualizohen permes shembullit te Kelp Forests. Me tej, Burimi perqendrohet tek koncepti i kufizimeve planetare duke treguar nje grup qe pergatit dhe prezanton nje kufi individual. Kjo pjese e pare eshte shtrire ne 120 minuta. Ketu, nese eshte e nevojshme, Burimi mund te ndahet ne dy sesione konsekuative.

Pas pjeses se pare, te ketij burimi, rezultati duhet te jete se " Biznes- si- zakonisht" nuk eshte me nje opsion. Mbi te gjitha studentet duhet te jene ne gjendje te reflektojne ne sjelljen aktuale shoqerore dhe individuale dhe te konkludojne se nje zhvillim me i qendrueshem eshte i nevojshem.

Pjesa e dyte e Burimit fokuson tek ndryshimet klimatike- si nje kufi madhor- ne rajonin e Ballkanit, kombinuar me idene e zhvillimit te qendrueshem. Nje pale interesi, mundesisht qe punon ne adaptimin e ndryshimeve klimatike ne rajon, mund te ftohet ( per sugjerime shiko me poshte). Ata duhet t e japin nje pamje te pergjithshme te ndikimeve te ndryshimeve klimatike ne rajon, masave adaptive dhe te ofrojne ide se cfare mund te behet per te penguar ndryshimet e metejshme klimatike. Pala e interesit duhet te punoje me studentet ne idete se si mund te transferohen njohurite e fituara ne jeten e perditshme si dhe ne fushen e studimit.

Nese nje pale interesi nuk eshte e aksesueshme ose nuk deshiron, lektori

jep nje input per ndryshimet klimatike ne rajon dhe rrjedhojat e tij ne dimensione te ndryshme te qendrueshmerise.

Ketu, me qellim qe te fitohen njohuri me te mira sesi individet ndikojne klimen, gjurmuesi ekologjik ose gjurmuesi i karbonit mund te llogaritet permes llogaritesve te tjere. Pas inputit dhe llogaritjes, nje diskutim ne formen e sesionit brainstorming ose nje reflektim i heshtur ne leter duhet te ndjehet. Me qellim zhvillimin e ideve per ato qe shoqeria dhe studentet mund te bejne per te menduar dhe vepruar ne nje menyre te qendrueshme.

Pas konkludimit te burimit, studentet duhet te kuptojne impaktin e njerezimit ne Toke dhe sesi ky ndikim rrezikon rrjedhimisht ekosistemet ne Toke. Ata duhet te kene nje pamje te pergjithshme te presioneve nen te cilat planeti yne dhe mjedisi rajonal vuan, te fitojne te kuptuarin e qendrueshmerise si dhe aftesine per te reflektuar ne sjelljen e tyre.

---

## Mjetet e mësimdhënies



Material i shkruar   Video   Njësi (mjete) matëse

## Integrimi i palëve të interesuara shoqërore

Pale te ndryshme interesi mund te konsiderohen te japin nje pamje te pergjithshme per ndikimet rajonale te ndryshimeve klimatike.

Pale te interesit te sugjeruara:

- Instituti per politiken e Zhvillimit ( Kosove)
- Agjensia kosovare per Mbrojtjen e Mjedisit
- Mbrojtja dhe Ruajtja e Mjedisit Natyror ne Shqiperi,
- Instituti per Politikat Ambjentaliste i Shqiperise

Palet e interesit duhet te japin nje pamje te pergjithshme te ndikimeve te ndryshimeve klimatike ne rajon, masat e adaptueshme, dhe te oftojne ide se cfare mund te behet per te penguar ndryshime te metejshme klimatike. Duhet te punohet me studentet per idete sesi njohurite e fituara mund te trasferohen ne jetet e perditshme si dhe ne fushen e studimit.

## Pika e forte

- Nderveprim midis lektorit dhe studenteve si dhe midis studenteve me

njeri-tjetrin

- Strukture fleksible kohore ( ose nje sesion me rreth 4 ore ose 2 sesione me 2 ore)
- E aksesueshme, jo njohuri te meparshme te kerkuara

## Pika e dobët

Prezantim: shume aspekte mund te diskutohen me tej

## Rezultatet e të mësuarit

- Njohurite e te kuptuarit te ndryshem te qendrueshmerise, sistemeve te ndryshme planetare dhe nje ekzemplar i ekosistemit te Pyjeve Kelp.
  - Duke kuptuar nderveprimin midis tyre dhe kompleksitetin e sistemeve
  - Duke kuptuar ndikimin e njerezimit ne sistemet e Tokes.
  - Duke kuptuar qellimet e zhvillimit te qendrueshem
  - Njohuri me te thella ne nje segment te konceptit te paraqitur.
  - Duke komunikuar dhe prezantuar njohurite shkencore
  - Reflektimin kritik tek sjellja e tyre si dhe parimet e ndryshme
  - Zhvillimi dhe thellimi i mendimit shkencor.
  - Reflektimi mbi problemet nga perspektiva/ kende te ndryshme
  - Lidhja e problemeve globale dhe lokale ose e fenomeneve
- Eshte nje parathenie per te mesuarin me shume per qendrueshmerine, zhvillimin e qendrueshem dhe arsyet se perse eshte nje ceshtje kaq e rendesishme.

## Lidhja për qëndrueshmëri

Duke perdorur konceptin e kufijve planetare, burimi i mesimdhenies perqendrohet ne dimensionin ekologjik te qendrueshmerise. Me qellim qe te fitohet nje i kuptuar sa me i plote i konceptit, burimi fillon dhe mbaron me integrimin e qendrueshmerise, shkurtimisht me qellim qe te fitohet nje i kuptuar me i gjere i idese. Duke perpunuar kufijte individuale planetare, studentet perfitojne me shume njohuri te sistemeve planetare dhe kuptojne lidhjet midis tyre. Mbi te gjitha, duke u perqendruar ne ndryshimet klimatike ne rajonin e Ballkanit, lidhja lokale e qendrueshmerise theksohet dhe studentet zhvillojne nje te kuptuar per perspektivat lokale dhe globale te qendrueshmerise. Studentet fitojne te kuptuar te qellimeve te qendrueshmerise si dhe njohurite e sistemeve , te cilat jane te nevojshme per te perfituar njohuri transformuese.

## Njohuri paraprake

Asnje lloj njohurie paraprake specifike nuk kërkohet?

## Përpjekjet e përgatitjes

Te□ pakta

## Përshkrimi i përpjekjeve të përgatitjes

Lektori duhet të printojë dokumente për punën në grup dhe diskutim dhe duhet të sigurohet për mundësinë e shfaqjes së një videoje. - Lektori duhet të njohi materialin - Nëse një pale interesuese është e gatshme, lektori duhet të ftojë palen e interesit dhe të diskutojë se çfarë mund të përgatisin për sesionin.

## Aksesi

Free

## Gjykimi / vlerësimi

- Studentët mund të shkruajnë një përmbledhje rishikuese
- Studentët mund të shkruajnë një reflektim për të gjithë temën me fokusin tek kufijtë që shprejnë, fokus në efektet rajonale, fokus në fushën e studimit dhe ndikimin e zhvillimit të qëndrueshëm në të. ( për më tepër informacion shiko : Burimi i mesimdhënieve- Udhezuesi.

## Kreditim/Çertifikatë

==

## Financuar nga

This teaching resource, realised within the project ConSus, has been funded with the support of the TEMPUS of the European Union. The contents reflect the views of the authors, and the European Commission cannot be held responsible for any use which may be made of the information contained therein.